



MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MIRËQENIES SOCIALE
SPITALI UNIVERSITAR I TRAUMËS

Nr _____ Prot

Tiranë, më ____/____/2026



Spitali Universitar i Traumes

RAPORTI VJETOR

SUT

VITI 2025

➤ BAZAT LIGJORE

- Ligji nr 115/2024 të miratuar nga Kuvendi datë 03.12.2024 : Për buxhetin e vitit 2025.
- Në zbatim të Udhëzimit të MFE nr 2 datë 24.01.2025 “Për zbatimin e buxhetit vjetor 2025”.
- Ligji nr. 9936/2008 datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Udhëzimit të MFE nr 7 datë 28.02.2018 “Per procedurat standarte të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm”
- Udhëzimit të MF nr.4 datë 28.02. 2024 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027.
- Vendimi nr 535 datë 12.08.2024 për ”Miratimin e Taveve perfundimtare të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027.
- Udhëzimi nr 9 dt 20.03.2018 te MFE “ Për procedurat standarte të zbatimit te buxhetit ”
- VKA me nr. 33 datë 04.12.2024 “Për Financimin e Shërbimeve Shëndetësore Spitalore nga skema e Detyrueshme e Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor për Vitin 2025”.
- VKM Nr. 1001, datë 2.12.2015 “Për integrimin e Spitalit Universitar të Traumës dhe Spitalit Ushtarak të Forcave te Armatosura në një strukturë të bashkuar” i ndryshuar me VKM 460 date 26.07.2023 Spitali Universitar i Traumës është institucion shëndetësor publik në varësi administrative të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
- VKM Nr.424 datë 26.06.2024 ”Për miratimin e strukture së pagave, niveleve te pagave e shtesave mbi pagë, kompesimeve dhe trajtimeve të tjera financiare të punonjesve të sistemit shëndetësor, në institucionet shëndetësore, në sistemin e ministrisë përgjegjese për shëndetësinë, në strukturat shëndetësore të forcave të armatosura të Republikës së Shqipërisë , të drejtorisë së përgjithshme të burgjeve, dhe të drejtorisë së përgjithshme të policisë së shtetit.
- VKM nr.422 datë 26.06.2024 “Për një ndryshime në vendimin Nr.326 datë 31.05.2023, te Këshillit te Ministrave, ”Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike te ndryshuar
- Kontratën me nr.28/7 datë 08.01.2025 me objekt “Kontratë për Financimin e Shërbimeve Shëndetësore Spitalore për vitin 2025 ndërmjet Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor dhe Spitalit Universitar të Traumës”.
- Shkresa e FSDKSH nr 3054 datë 05.07.2024 “ Për procedurat e hartimit të projekt buxhetit për vitin 2025-2027.
- VKM Nr.535 datë 12.08.2024 “Për miratimin e taveve perfundimtare të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 ”

➤ **AKTIVITETI FINANCIAR I SPITALIT UNIVERSITAR TË TRAUMËS**

Spitali Universitar i Traumës, në përmbushje të misionit të tij për ofrimin e shërbimit shëndetësor, me fokus parësor trajtimin e politraumave në nivel terciar për të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe garantimin e shërbimeve shëndetësore të përgjithshme për komunitetin, ka zhvilluar gjatë vitit 2025 një aktivitet financiar të qëndrueshëm dhe të kontrolluar, në përputhje të plotë me kuadrin ligjor dhe aktet nënligjore në fuqi.

Menaxhimi financiar është realizuar mbi bazën e parimeve të eficiencës, transparencës dhe përdorimit racional të fondeve publike, duke garantuar funksionimin normal dhe të pandërprerë të aktivitetit spitalor. Planifikimi, zbatimi dhe monitorimi i buxhetit kanë qenë të orientuara drejt sigurimit të vazhdimësisë së shërbimit shëndetësor, përmbushjes së nevojave operacionale të institucionit dhe përmirësimit të cilësisë së shërbimit ndaj pacientëve.

Gjatë vitit raportues, Spitali Universitar i Traumës ka përmbushur në kohë të gjitha detyrimet financiare, pa krijuar detyrime të prapambetura ndaj operatorëve ekonomikë, institucioneve shtetërore apo punonjësve. Pagesat për paga, kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, si dhe shpenzimet operative janë kryer rregullisht dhe brenda afateve ligjore.

Njëkohësisht, është siguruar ndjekja, monitorimi dhe raportimi periodik i realizimit të buxhetit pranë Ministrisë së Mbrojtjes dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si dhe rakordimi i vazhdueshëm me Drejtorinë e Thesarit. Evidentimi dhe kontrolli i shpenzimeve janë kryer në mënyrë sistematike, duke garantuar disiplinë buxhetore dhe korrektësi financiare gjatë gjithë vitit.

Si rezultat i këtij menaxhimi financiar, buxheti i alokuar për vitin 2025 është realizuar në masën 99.3%, duke reflektuar një administrim efektiv të fondeve publike dhe një performancë financiare të qëndrueshme në funksion të përmbushjes së objektivave institucionale.

➤ **BUXHETI MM + MSHMS – VITI 2025**

Për vitin 2025, Spitalit Universitar të Traumës i është alokuar një buxhet total nga Ministria e Mbrojtjes për paga, kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, shpenzime operative dhe investime, në vlerën **1,919,439,960** lekë, si dhe një buxhet nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në vlerën **650,600,000** lekë.

Në total, vlera e buxhetit të lëvruar gjatë vitit 2025 ka qenë **2,570,039,960** lekë.


Gjatë zbatimit të buxhetit:

- Nuk janë krijuar detyrime të prapambetura, si rezultat i përmbushjes në kohë të detyrimeve ndaj të gjithë operatorëve ekonomikë të kontraktuar.
- Detyrimet mujore për ujë, energji elektrike, taksa dhe shërbime të tjera janë likuiduar rregullisht dhe brenda afateve ligjore.
- Janë realizuar në kohë pagesat e pagave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për të gjithë punonjësit.
- Sektori i Financës ka raportuar çdo muaj situacionet e realizimit të buxhetit pranë Ministrisë së Mbrojtjes dhe

Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të rakorduar me Drejtorinë e Thesarit.

- Janë hartuar rregullisht evidencat mujore të shpenzimeve, të rakorduar me Drejtorinë e Thesarit.
- Buxheti për periudhën janar–dhjetor 2025 është realizuar në vlerë totale në masën 99.3%, sipas paraqitjes analitike të detajuar më poshtë.

ART.	EMERTIMI	PLAN VJETOR	FAKT PROGRESIV	REALIZIM %
600	Paga te personelit	893,136,000	885,316,294	99.1%
601	Kontribute te sigurimeve shoqerore dhe shendetesore	147,300,000	143,957,884	97.7%
602	Mallra dhe sherbime	1,328,164,000	1,325,448,010	99.8%
6020	<i>Materiale/shërbime zyre, te përgjithshme</i>	3,916,860	3,916,860	100.0%
6021	<i>Materiale dhe shërbime speciale</i>	931,582,701	929,096,878	99.7%
6022	<i>Shërbime nga të tretë</i>	264,696,045	264,623,697	100.0%
6023	<i>Shërbime transporti</i>	4,613,813	4,613,714	100.0%
6024	<i>Shpenzime udhetimi</i>	228,500	228,500	100.0%
6025	<i>Shpenzime per mirembajtje</i>	115,561,775	115,404,055	99.9%
6026	<i>Shpenzime per qiramarrje</i>	204,400	204,400	100.0%
6027	<i>Shpenzime per detyrime, kompensime lagale</i>	4,537,500	4,537,500	100.0%
6029	<i>Shpenzime te tjera operative</i>	2,822,406	2,822,406	100.0%
606	Transferta per buxhete familjare dhe individet	4,439,960	4,406,131	99.2%
231	Studime dhe projekte dhe investime	197,000,000	193,284,800	98.1%
	TOTALI	2,570,039,960	2,552,413,119	99.3%
	NUMRI I PUNONJESVE	624	609	97.6%



➤ **BUXHETI SUT – KRAHASIM DHE ANALIZË E SHKURTËR 2024–2025**


Krahasuar me vitin 2024, viti buxhetor 2025 paraqet një përmirësim të ndjeshëm në drejtim të zbatimit dhe monitorimit të fondeve buxhetore të Spitalit Universitar të Traumës. Niveli i realizimit të buxhetit në masën **99.3%** tregon një disiplinë më të lartë financiare dhe një eficiencë më të mirë në përdorimin e fondeve.

Gjatë vitit 2025, fondet e alokuara për **paga dhe kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore** janë administruar në mënyrë të qëndrueshme, duke garantuar pagesa të rregullta dhe në kohë për personelin. Po ashtu, shpenzimet për **mallra dhe shërbime**, në veçanti për medikamente, materiale mjekësore dhe shërbime shëndetësore, janë realizuar në përputhje me nevojat reale të institucionit, duke përmirësuar mbulimin e kërkesave të pacientëve krahasuar me vitin pararendës.

Në drejtim të **investimeve**, viti 2025 ka shënuar një nivel realizimi më të mirë krahasuar me vitin 2024, duke kontribuar në përmirësimin e infrastrukturës dhe mbështetjen e kapaciteteve shërbimore të spitalit. Gjithashtu, gjatë vitit 2025 nuk janë krijuar detyrime të prapambetura, çka përbën një tregues pozitiv të menaxhimit financiar krahasuar me praktikatat e viteve të mëparshme.

Në tërësi, krahasimi 2024–2025 dëshmon se viti 2025 ka përfaqësuar një periudhë më të konsoliduar në aspektin financiar, duke mbështetur në mënyrë më efektive realizimin e misionit dhe objektivave institucionale të Spitalit Universitar të Traumës.

SUT BUXHETI TOTAL NE VITE				
VITI	600+601 Paga dhe Sigurime	602 +606 Shpenzime Korrente	231 INVESTIME	TOTAL BUXHETI
2021	733,050,000	886,993,000	200,000,000	1,820,043,000
2022	679,063,500	1,099,985,245	250,000,000	2,029,048,745
2023	777,936,000	1,188,253,720	170,700,000	2,136,889,720
2024	896,716,000	1,331,020,289	370,000,000	2,597,736,289
2025	1,040,436,000	1,332,603,960	197,000,000	2,570,039,960



➤ **TË ARDHURAT VITI 2025**

- Spitali Universitar i Traumes për periudhën **Janar - Dhjetor 2025** ka realizuar në **total 18,147,606 lekë** nga të ardhura spitalore dhe të ardhura nga qeratë, të cilat trashëgohen në vitin pasardhës.
- Nga të ardhurat e mësipërme nga kontratat e qerasë për vitin 2025, pjesa e derdhur në buxhet është vlera 1,935,136 leke. Bashkelidhur pasqyrat.

Nr	Emertimi I llogarisë	Të ardhurat progresive	Derdhur në buxhet (30% e qerave)	Pjesa e Institucionit
1	Të ardhura nga qiratë deri 200 m	1,266,530	379,959	886,571
2	Të ardhura nga qiratë mbi 200 m	4,282,080	1,284,624	2,997,456
3	Të ardhura spitalore	11,792,635		11,792,635
4	Të ardhura të tjera	535,808		535,808
5	Sekuestime dhe zhdemtime	270,553	270,553	
	TOTALI	18,147,606	1,935,136	16,212,470

Të ardhurat e trashëguara nga viti paraardhës janë përdorur gjatë viti 2025 si më poshtë:

Artikulli	Emertimi	Buxheti Plan 2025	Realizimi 2025	Mbetur për tu përdorur
231	Investime	14,183,217	1,209,600	12,973,617
602	Mallra dhe shërbime	5,142,850	2,397,120	2,745,730
600	Paga dhe shperblime	5,519,195	5,519,195	0
	TOTALI	24,845,262	9,125,915	15,719,347

Vlera e mbetur nga përdorimi përkatesisht 15,719,347 lekë minus rritjet e autorizuara 1,289,172 lek së bashku me të ardhurat e krijuara gjatë vitit 2025 do të përdoren për nevoja të ndryshme gjatë vitit në vazhdim 2026.

➤ **PROCEDURAT E PROKURIMIT TE VITIT 2025**

- Sipas regjistrit të Realizimit për procedurat e prokurimit të vitit 2025 janë realizuar 40 procedura prokurimi të ndara sipas llojit si më poshtë:

- **25 blerje me vlere te vogel (13 blerje nen 100 mije)**
- **2 procedura mbi kufirin e larte monetar (nderkombetare)**
- **1 procedure mbi kufirin e ulet monetar (e Hapur)**
- **5 procedura prokurimi te hapura te thjeshtuara.**
- **7 procedura jane zhvilluar nga organet qendrore blerese**
- **Minikontrata jane nenshkruar dhe realizuar 164**

➤ **Marrëveshje Kuadër Viti 2025.**

SUT ka lidhur mini-kontrata sipas Marrëveshjeve Kuader kuadër qe kishte në proces dhe ato te reja te vitit 2025. **Për periudhën Janar - Dhjetor 2025 jane realizuar ne vlerë 1,139,851,465 lekë me TVSH.**

Bashkëlidhur tabela e detajuar e Marrëveshjeve Kuadër me vlerat përkatëse të zbatuara gjatë vitit 2025.

Nr	Emertimi	Vlera e Marreveshjeve Kuader me Tvsh e realizuar gjate viti 2025
	1. Sherbimet mbeshtetese ne SUT	
1	Kryerje e sherbimit te lavanderise ne SUT	116,808,000
2	Sherbim mirembajtje objekte ndertimore ne SUT	8,360,364
3	Riparim mirembajtje sistem ngrohje ftohje SUT	5,097,441

4	Riparim dhe mirembajtje autoambulance	8,674,680
5	Sherbim i gjelberimit per Sut	4,553,087
6	Sherbim evadimit te mbeturinave urbane ne SUT	4,769,820
7	Sherbim I mirembajtje Full Risk Rezonan Magnetike	5,988,365
8	Furnizim me lende djegese per automjete diesel (gazoil)	2,703,474
9	Trajtim mbetje spitalore	34,987,680
10	Sherbim gatimi/ shperndarje ushqimi per SUT	14,838,060
11	Riparim/ Mirembajtje aparaturave mjekesore te SUT	37,198,078
12	Sherbim mirembajtje te ashensoreve ne SUT	5,425,200
13	Sherbim pastrimi per SUT	49,629,919
14	Furnizim me dokumentacion specifik	388,440
15	Blerje materiale te ndryshme pastrimi	5,778,000
16	Mirembajtje sistemi informatik SIIS	33,735,000
17	Blerje materiale kancelari	1,413,960
	Totali 1	340,349,568
	2. Materiale Specifike per Sherbimet Mjekesore ne SUT	
1	Blerje materiale mjekimi per Kirurgjine Maxilofaciale ne SUT	15,811,400
2	Blerje materiale mjekimi specifike per Neurokirurgjine ne SUT	105,036,568
3	Furnizim me mallra kite dhe reagente per aparatit e astrupit ne SUT	3,064,800
4	Furnizim meshiringa dual + filma dhe solucion lares per imazherine	4,120,560
5	Furnizim materiale per marjen e mostrave te gjakut per pacientet	4,178,100
6	Blerje materiale konsumi per Artroskopine ne SUT	3,755,280
7	Materiale mjekimi kempa diabetike dhe kirurgjia vazale	14,728,120
8	Blerje Materiale Konsumi (IMPLANTE ORTOPEDIKE) per Sherbimin e Ortopedise ne SUT	204,454,675
9	Materiale mjekimi te pergjithshme per nevoja spitalore Materiale mjekimi konsumi dhe kirurgjikale per nevoja spitalore	65,971,485
10	Blerje materiale terapine renale	26,818,200
11	Blerje materiale konsumi per kirurgji gastrotentinale dhe laparoskopike	30,592,420
12	Blerje materiale mjekimi per vak terapin	5,339,520
13	Blerje materiale per sherbimin e urologjise sut	15,223,680
14	Blerje materiale per aparaturat e sherbimit te reanimacionit	4,211,520
	Totali 2	503,306,328
	3. Barna Mjekesore	
1	Blerje gazra mjeksore per SUT	21,163,872
2	Blerje Barna B1+B2	216,166,897
	Totali 3	237,330,769
	4. Blerje Aparatura dhe Pajisje Mjekesore	
1	Blerje Aparatura dhe Pajisje Mjekesore	58,864,800
	Totali 4	58,864,800
	Totali 1+2+3+4	1,139,851,465

➤ **OBJEKTIVAT E SPITALIT UNIVERSITAR TË TRAUMËS PËR VITIN 2026**

Në funksion të përmbushjes së misionit të tij dhe rritjes së vazhdueshme të cilësisë së shërbimit shëndetësor, Spitali Universitar i Traumës ka përcaktuar për vitin 2026 objektivat e mëposhtme strategjike dhe operationale:

1. Përmirësimi i Infrastrukturës dhe Teknologjisë

- Përfundimi i punimeve për rikonstrukcionin e ambienteve të jashtme dhe të korpusit qendror të spitalit.
- Modernizimi i infrastrukturës teknologjike në funksion të përmirësimit të kushteve të shërbimit dhe sigurisë së pacientëve.

2. Përmirësimi i Shërbimeve Mjekësore

- Rinovimi dhe zëvendësimi i aparaturave mjekësore të amortizuara për shërbimet shëndetësore të Spitalit Universitar të Traumës.
- Reduktimi i listës së pritjes për ndërhyrjet ortopedike të planifikuara, nëpërmjet rritjes së eficiencës operative dhe menaxhimit të burimeve.
- Sigurimi i mbulimit të plotë të spitalit me medikamente, materiale mjekësore dhe materiale specifike, në përputhje me standardet e shërbimit shëndetësor.

2. Zhvillimi i Burimeve Njerëzore dhe Trajnimi

- Rritja e kapaciteteve profesionale të personelit përmes programeve të edukimit të vazhdueshëm dhe trajnimeve të specializuara.
- Zbatimi i programeve të rregullta të edukimit në vazhdim për personelin mjekësor dhe administrativ të SUT.

3. Menaxhimi dhe Efikasiteti Financiar

- Realizimi në kohë i të gjitha procedurave të planifikuara të prokurimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- Realizimi i plotë i buxhetit të miratuar të Spitalit Universitar të Traumës për vitin 2026, duke garantuar disiplinë financiare dhe përdorim efikas të fondeve publike

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
EDLIRA BODE

Punoi :

Ardit Osmani

Miratoi :

Ermira Bregu

Fatbardh Shehaj